



**BASHKIA BERAT**  
**DREJTORIA E SHËRBIMIT SOCIAL**

**RELACION**

**MBI PËRDORIMIN E FONDIT TË SHËRBIMIT SOCIAL, MBËSHTETJE  
FINANCIARE NË RASTE FATKEQËSIE PËR TË NDJERIN Z.GANI HODO**

Drejtoria e Shërbimit Social dhe Drejtoria e Financës, bazuar në kërkesën e bërë nga *Xhulieta Hodo* me nr. 517 prot, datë 20.04.2026, mbështetur në ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin nr. 57/2019 “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”, V.K.M-së nr. 597, datë 04.09.2019, e ndryshuar, datë 29.12.2021, “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike” vendimit nr. 722, datë 11.11.2019 “, VKB-së nr.3, datë 27.01.2025 “Për miratimin e kriterëve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për bllok - ndihmën ekonomike deri në 6% dhe nga fondet e drejtorisë së Shërbimit Social”, VKB-së nr.108, datë 18.12.2024 “Per miratimin e buxhetit te vitit 2025 dhe PBA përfundimtare 2025-2027”, ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” neni 4 pika 4, ligjin nr.121/2016 “Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, vendim nr. 518, datë 03.10.2018 “Për procedurat e referimit e të menaxhimit të rastit, hartimin dhe përmbajtjen e planit individual të mbrojtjes, financimin e shpenzimeve për zbatimin e tij, si dhe zbatimin e masave të mbrojtjes”, ligjin nr. 22/2018 “Për Strehimin Social”.

**JU RELATOI:**

Të nderuar këshilltarë!

I ndjeri z. Gani Hodo, ka jetuar në lagjen “Kushtrim” ku prej 12 vitesh ku ka qënë i diagnostikuar si para-tetraplegjik pas një tensioni të lartë dhe me statusin e invalidit të plotë të punës. Familja, përbëhet nga dy anëtarë dhe jeton në kushte shumë të vështira ekonomike ku të ardhurat mujore janë të pamjaftueshme. Burimi i të ardhurës së vetme që ka familja është pension minimal i znj.Hodo që mezi mbulojnë nevojat bazë të jetesës si ushqimi, energjia elektrike, medikamentete dhe shpenzimet e tjera familjare.

Në bazë të verifikimeve dhe informacionit të administruar pranë familjes, rezulton se gjendja social-ekonomike e kësaj familje është e vështirë dhe të ardhurat mujore janë të pamjaftueshme për të përballuar shpenzimet e ceremonise mortore dhe varrimit.



4

Ku vdekja e të ndjerit ka rënduar më tej gjendjen ekonomike dhe sociale të familjes, duke e bërë të pamundur sigurimin e të gjitha shërbimeve të nevojshme funerale pa mbështetje financiare.

Gjatë vizitave në familje, nga strukturat e shërbimit social, është vlerësuar situatë e vështirë e jetesës që familja ka dhe pamundësia ekonomike.

Duke u bazuar në historikun, problematikat e rastit dhe vlerësimin social nga strukturat e shërbimit social, pamundësive financiare për të përballuar shpenzimet e varrimit, kërkesës së paraqitur nga **znj. Xhulieta Hodo** drejtorja e Shërbimit Social, propozon të përballoj shpenzimet e varrimit, në shumën 46.000 (dyzet e gjashtë mijë) lekë.

Bashkëngjitur gjeni:

1. Certifikatë familjare.
2. Certifikata e vdekjes.
3. Fotokopje karta ID.
3. Kërkesën nga znj. Xhulieta Hodo.
5. Faturë tatimore nga subjekti funeral.

**DREJTOR I SHËRBIMIT SOCIAL**

Piro Xheblati



**BASHKIA BERAT**  
**DREJTORIA E SHËRBIMIT SOCIAL**

**RELACION**

**MBI PËRDORIMIN E FONDIT TË SHËRBIMIT SOCIAL, MBËSHTETJE  
FINANCIARE NË RASTE FATKEQËSIE PËR TË NDJERËN MANUSHAQE  
KAPLLANI**

Drejtoria e Shërbimit Social dhe Drejtoria e Financës, bazuar në kërkesën e bërë nga znj.Liljana Kapllani me nr. 652 prot, datë 14.05.2026, mbështetur në ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin nr. 57/2019 “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”, V.K.M-së nr. 597, datë 04.09.2019, e ndryshuar, datë 29.12.2021, “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike” vendimit nr. 722, datë 11.11.2019 “, VKB-së nr.3, datë 30.01.2026 “Për miratimin e kriterëve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për bllok - ndihmën ekonomike deri në 6% dhe nga fondet e drejtorisë së Shërbimit Social”, VKB-së nr.108, datë 18.12.2024 “Per miratimin e buxhetit te vitit 2026 dhe PBA përfundimtare 2026-2028”, ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” neni 4 pika 4, ligjin nr.121/2016 “Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, vendim nr. 518, datë 03.10.2018 “Për procedurat e referimit e të menaxhimit të rastit, hartimin dhe përmbajtjen e planit individual të mbrojtjes, financimin e shpenzimeve për zbatimin e tij, si dhe zbatimin e masave të mbrojtjes”, ligjin nr. 22/2018 “Për Strehimin Social”.

**JU RELATOI:**

Të nderuar këshilltarë!

E ndjera znj.Manushaqe Kapllani, rreth moshës 65 vjecare, anëtare e komunitetit egjiptian, person i identifikuar në situatë rruge edhe pse kishte banesë të qëndrueshme, njëhej si nga komuniteti dhe të afërm që qëndronte në ambiente publike të papërshtatshme. Gjatë vizitave në familje nga strukturat e shërbimeve shoqërore, personi paraqitej me vështirësi në përmbushjen e nevojave bazë si ushqimi, higjena dhe së fundmi edhe paqëndrueshmëri mendore dhe emocionale. E ndjera shfaqte herë pas here edhe nevojën për ndihmë mjekësore dhe mbështetje sociale.



Vajza e vetme e saj, e martuar dhe me tre fëmijë të mitur rezultojnë që edhe ajo përballet me vështirësi ekonomike apo sociale. Është familje e identifikuar nga shërbimi social si me vështirësi social ekonomike dhe është përfshirë në skemën e ndihmës ekonomike, programeve të strehimit social duke e referuar pranë edhe institucioneve për riintegrimin në tregun e punës.

E ndjera dhe vajza e saj janë ndjekur nga strukturat e shërbimit social dhe ju është ofruar përherë ndihmë emergjente dhe plane integrimi social.

Duke u bazuar në historikun, problematikat e rastit dhe vlerësimin social nga strukturat e shërbimit social, personi e cila nuk zotëron asnjë pasuri, pamundësive financiare për të përballuar shpenzimet e varrimit nga vajza e saj, kërkesës së paraqitur nga **znj. Liljana Kapllani, drejtorja e Shërbimit Social**, propozon të përballojë shpenzimet e varrimit, në shumën 65.000 (gjashtëdhjetë e pesë mijë) lekë.

Bashkëngjitur gjeni:

1. Certifikatë familjare.
2. Certifikata e vdekjes.
3. Kërkesën për mbështetje nga vajza e të ndjerës Liljana Kapllani.
4. Faturë tatimore nga subjekti funeral.

**DREJTOR I SHËRBIMIT SOCIAL**

Piro Xheblati



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT

Berat, më \_\_\_\_/\_\_\_\_/2026

## RELACION

### PËR MIRATIMIN E RAPORTIT TË PERFORMANCËS SË BASHKISË BERAT PËR VITIN 2025

Të nderuar Këshilltarë,

Në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, të Ligjit nr. 68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe në zbatim të politikave kombëtare për forcimin e qeverisjes vendore, transparencës institucionale dhe monitorimit të performancës së shërbimeve publike, paraqitet për miratim në Këshillin Bashkiak Berat Raporti i Performancës së Bashkisë Berat për vitin 2025.

Raporti i Performancës për vitin 2025 është hartuar nga Njësia e Monitorimit të Performancës pranë Bashkisë Berat, në bashkëpunim me drejtoritë dhe sektorët përkatës të institucionit, bazuar në të dhënat statistikore, financiare, administrative dhe operacionale të mbledhura gjatë vitit ushtrimor 2025. Ky raport përbën një instrument të rëndësishëm monitorimi dhe vlerësimi, i cili pasqyron në mënyrë të strukturuar nivelin e realizimit të objektivave strategjike, programeve buxhetore dhe treguesve kryesorë të performancës së Bashkisë Berat.

Hartimi i raportit është realizuar në kuadër të procesit të ngritjes dhe forcimit të sistemit të matjes së performancës në nivel vendor, në përputhje me metodologjinë standarde të rekomanduar nga projekti “Bashki të Forta”, në bashkëpunim me organizatën Smart Process. Në këtë kuadër, Bashkia Berat ka qenë pjesë e trajnimeve dhe asistencave teknike lidhur me metodologjinë e mbledhjes së informacionit nga drejtoritë dhe sektorët e Bashkisë, përpunimin dhe analizimin e të dhënave, ndërtimin e treguesve të performancës, si dhe hedhjen e tyre në dashboard-et përkatëse të monitorimit dhe raportimit institucional.

Ky proces synon krijimin e një sistemi funksional dhe të qëndrueshëm të matjes së performancës, i cili mundëson monitorimin e eficiencës dhe efektivitetit të përdorimit të fondeve publike, nivelit të realizimit të shërbimeve publike dhe progresit institucional të Bashkisë Berat. Gjithashtu, sistemi i monitorimit të performancës synon të mbështesë procesin e vendimarrjes institucionale nëpërmjet analizimit të treguesve konkretë dhe të matshëm, duke ndihmuar në identifikimin e prioriteteve dhe nevojave për përmirësim të mëtejshëm.

Raporti i Performancës për vitin 2025 paraqet vlerësimin e treguesve kryesorë të shërbimeve publike dhe administrative të Bashkisë Berat, si dhe rekomandime për përmirësimin e tyre. Në raport janë përfshirë analiza dhe vlerësime për fusha të rëndësishme të funksionimit të Bashkisë, ndër të cilat:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## BASHKIA BERAT

3

1. Arsimi
2. Infrastruktura e Ujitjes dhe Kullimit
3. Administrimi i Pyjeve dhe Kullotave
4. Mbrojtja nga Zjarri dhe Mbrojtja Civile
5. Menaxhimi i Mbetjeve
6. Përkujdesi Social
7. Strehimi Social
8. Shërbimet Publike Vendore
9. Infrastruktura Rrugore Rurale
10. Policia Bashkiake
11. Bujqësia, Inspektimi dhe Siguria Ushqimore
12. Trashëgimia Kulturore dhe Aktivitetet Artistike
13. Burimet Njerëzore
14. Menaxhimi Financiar
15. Të Ardhurat
16. Buxheti
17. Shpenzimet

Për secilën prej këtyre fushave janë analizuar treguesit kryesorë të performancës, niveli i realizimit të objektivave të planifikuara, përdorimi i burimeve financiare dhe administrative, si dhe rezultatet konkrete të arritura gjatë vitit 2025. Nëpërmjet këtij raporti realizohet një analizë krahasimore ndër vite, duke evidentuar progresin institucional, tendencat e zhvillimit dhe sfidat që kërkojnë ndërhyrje apo përmirësim të mëtejshëm.

Raporti përmban të dhëna të detajuara statistikore dhe financiare, të paraqitura përmes tabelave, grafikëve dhe analizave krahasimore, me qëllim krijimin e një panorame të qartë mbi performancën institucionale të Bashkisë Berat. Këto të dhëna shërbejnë si bazë për vlerësimin e eficiencës së përdorimit të fondeve publike dhe cilësisë së shërbimeve të ofruara ndaj qytetarëve.

Një rëndësi e veçantë në këtë raport i është kushtuar edhe monitorimit të realizimit të programeve buxhetore dhe investimeve publike, duke evidentuar ndikimin e tyre në përmirësimin e infrastrukturës, shërbimeve publike dhe kushteve të jetesës së komunitetit. Gjithashtu, raporti synon të evidentojë nivelin e transparencës dhe llogaridhënies institucionale në administrimin e burimeve publike.

Hartimi periodik i Raportit të Performancës përbën një mekanizëm të rëndësishëm për forcimin e kulturës së monitorimit dhe menaxhimit me bazë performance në Bashkinë Berat. Nëpërmjet këtij procesi synohet rritja e transparencës institucionale, forcimi i besimit të qytetarëve ndaj institucionit dhe përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë së shërbimeve publike.

Raporti i Performancës së Bashkisë Berat për vitin 2025 është vlerësuar nga projekti “Bashki të Forta” si një nga raportet më të realizuara në nivel vendor, si përsa i përket respektimit të afateve kohore, ashtu edhe cilësisë së mbledhjes, përpunimit dhe analizimit të treguesve të performancës, në përputhje me metodologjinë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA BERAT**

standarde të rekomanduara. Ky vlerësim përbën një tregues pozitiv të angazhimit institucional të Bashkisë Berat për forcimin e sistemeve të monitorimit, transparencës dhe përmirësimit të vazhdueshëm të performancës institucionale.

Në vijimësi të këtij procesi, Bashkia Berat mbetet e angazhuar për forcimin e mëtejshëm të sistemeve të monitorimit dhe raportimit të performancës, rritjen e kapaciteteve administrative dhe përmirësimin e vazhdueshëm të shërbimeve publike, me synim garantimin e një administrate vendore sa më eficiente, transparente dhe në shërbim të qytetarëve.

Për sa më sipër, propozohet miratimi nga Këshilli Bashkiak Berat i Raportit të Performancës së Bashkisë Berat për vitin 2025.

**PËRGATITI:**

Njësia e Monitorimit të Performancës

**Kryetar Grupi :** Arisa Toska

**Koordinator:** Marius Qytyka

**Specialist:** Jorida Papa

**KRYETARI I BASHKISË**  
ERVIN CECA